

EKO SHKOLLA



EKO KLUBI "HAMDI BERISHA"





♦ Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Gjimnazit "Hamdi Berisha" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



FAKTE MBI DITËN E TOKËS

Kualiteti i jetës dhe i shëndetit të njeriut është i lidhur ngushtë edhe me vet shëndetin dhe kujdesin ndaj natyrës, prandaj shumë ambientalist ja kushtuan mundin dhe punën e vet kësaj çështje.

Në vitin 1969 në një Konferencë të UNESCO-së në San Francisko, aktivisti i paqes John McConnell propozoi një ditë për të nderuar Tokën dhe konceptin e paqes, që së pari herë u festua më 21 mars 1970.

Një muaj më vonë Senatori i SHBA-ve, Gaylord Nelson propozoi idenë për të organizuar një mësim mbar-kombëtarë mbi mjedisin. Ai angazhoi një aktivist të ri Denis Hayes dhe riemëruan ngjarjen "Dita e Tokës".

Dita e Tokës është një ngjarje vjetore që festohet në të gjithë botën ku për herë të parë kjo ditë u festua me 22 prill, të vitit 1970, për të demonstruar kështu mbështetjen për mbrojtjen e mjedisit.



EDUKIMI MJEDISOR

Edukimi mjedisor është rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohurive mbi mjedisin dhe rreth tij. Ky proces i ndihmon njerëzit të zhvillojnë ndjeshmërinë ndaj natyrës dhe mjedisit që i rrethon. Ai nxit të kuptuarit me mire se si funksionon mjedisi!

Fjalja “Edukim Mjedisor” është një kocept i cili në fillim u theksua dhe u zhvillua nga Patrick Geddes (1854-1932), i cili ishte pioneri i lëvizjes mjedisore. Idetë e tij si: "Mendo globalisht, vepro lokalisht", janë bërë shumë të zakonshme".

Ai ia dedikoi jetën e tij edukimit dhe mjedisit, madje ai e theksoi edhe një qasje holistike (gjithpërfshirëse) që ka ndihmuar mbi studimet rreth edukimit mjedisor.

Qëllimi i këtij procesi është që të zhvillojë një “popullsi të botës” që është e ndërgjegjshme dhe e shqetësuar për mjedisin dhe problemet lidhur me të, e cila ka njohuritë, aftesitë, sjelljet, motivimin dhe zotimin për të punuar individualisht.



MBROJTJA DHE RUAJTJA E BIODIVERSITETIT

Biodiversiteti është një term i përdorur për të përshkruar larmishmerinë dhe kompleksitetin e jetës së gjallesave në tokë, ku përfshinë jo vetëm numrin e llojeve por edhe ndryshueshmërinë gjenetike, strukturën e komunitetit dhe funksionet ekologjike të tyre.

Biodiversiteti në Kosovë:

Kosova është një vend me biodiversitet të pasur, duke përfshirë shumë lloje të kafshëve, bimëve dhe mjedisit të tyre natyror. Që të mbrohet biodiversiteti në Kosovë duhet përfshirë gjitha nivelet e shoqërisë dhe të ndërmerren veprime.

- Krijimi i parqeve të biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura;
- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit;
- Promovimi i turizmit të qëndrueshëm;
- Rritja e ndërgjegjësimit për ruajtjen e biodiversitetit;
- Promovimi i praktikave të qëndrueshme nga bizneset dhe fermerët.

Shkaktarët e dëmshëm mbi biodiversitetin:

- humbja e habitatit;
- ndryshimi klimatik;
- ndërhyrja e njeriut në mjedis;
- shkatërrimi i bimësisë;
- ndërrimi i lëndës gjenetike.



RËNDËSIA E RUAJTJES SË MJEDISIT

Ruajtja e mjedisit është shumë e rëndësishme, me dëmtimin e saj nuk ndikohemi vetëm ne por edhe shumë organizma tjerë të gjallë.

Ruajtja nuk nënkupton mos shfrytëzimin e natyrës, sepse asetet e saj i janë dhuruar njeriut mirëpo ky përdorim të jetë i kontrolluar në atë formë që të mos dëmtoj mjedisin.

Me fjalë të tjera, nëse një strukturë, objekt ose habitat natyror i sjell dobi mbarëvajtjes dhe zhvillimit të jetës, ai kërkohet të ruhet në gjendjen e tij origjinale. Ne nuk do ti kishim ato pak vende të mbetura natyrore që janë të mbushura me biodiversitet, nëse lëvizja e ruajtjes nuk do kishte drejtuar rrugën.

Mbrojtja e ekosistemeve, kafshëve dhe bimëve nga ndërhyrja e dorës së njeriut është veprimi më i mirë që mund të bëjë njeriu. Pra, me pak fjalë e ardhmja e mjedisit në Tokë varet nga vetë ne, dhe nga gjeneratat e reja të cilat do të vetëdijesohen për problemet mjedisore dhe duke marrë masa për eliminimin e tyre dhe sigurimin e një mjedisi sa më të pastër.


Prandaj, “MBJELL NJË BIMË SOT PËR NJË TË ARDHME SA MË TË NDRITUR NESËR”





AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EC MA NDRYSHE



EKO KLUBI "HAMDI BERISHA"

MALISHEVË, KOSOVO

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".